



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE I
FAKULTETIT TË BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT**

Tiranë, më 09 /10/ 2025

Njoftim

**Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët që kandidojnë për anëtarët
e komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” të
Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, UBT**

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët që kandidojnë për anëtarët e komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” të Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, UBT Bazuar në Rregulloren e Zgjedhjeve të Universitetit Bujqësor të Tiranës, neni 25, dokumentat që duhet të dorëzojnë kandidatët që kandidojnë për anëtarët e komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në FBU, UBT. janë si më poshtë:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Dëshminë e penalitetit;
- c) Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- d) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- e) Kopje të noterizuar të titullit akademik;
- f) Vërtetimin e verifikimit të ligjshmërisë së dosjes të promovimit akademik dhe vlerësimin antiplagjaturë për kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme me vetëdeklarim.
- g) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.

Dokumentat do të dorëzohen në Zyren 105, duke filluar nga data **20.10.2025-24.10.2025**, ora **8:00-16:00**.

Pas regjistrimit, çdo kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit (tip) si kandidat prej komisionit zgjedhor që kryen regjistrimin e tij.

Sekretari i KZF

Vilma Gurazi